



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë

Numër 23

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

(TM1 2025 dhe pritjet për TM2 2025)

Numër 23

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK) -----	5
Hyrje -----	5
Përmbledhje-----	6
1.0 Kreditë ndaj ndërmarrjeve -----	7
1.1 Standardet kreditore -----	7
1.2 Kushtet dhe rregullat-----	7
1.3 Kërkesa për kredi-----	8
1.4 Cilësia kreditore-----	9
2.0 Kreditë ndaj ekonomive familjare-----	9
2.1 Standardet kreditore -----	9
2.2 Kushtet dhe rregullat-----	10
2.3 Kërkesa për kredi-----	11
2.4 Cilësia kreditore-----	12
3.0 Financimi-----	12
3.1 Përmbledhje e pyetjeve të fokusuara. -----	13
4.0 Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit-----	13
Pritjet për inflacionin -----	16

Shkurtesat

AKBK – Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

FKGK – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

NVM- Ndërmarrjet e vogla të mesme

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2025, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e dytë të vitit 2025.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me dy pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet eminente në sektorin bankar, si dhe zbërthimin e ofertës dhe kërkesës kreditore për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik.

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

Përmbledhje

Dinamika e kreditimit gjatë tremujorit të parë u nxit si nga oferta kreditore ashtu edhe nga kërkesa. Oferta kreditore u lehtësua deri në një masë për NVM-të dhe ekonomitë familjare në përgjithësi, ndërkohë që për ndërmarrjet e mëdha mbeti kryesisht e pandryshuar. Në anën tjetër, kishte kërkesë të lartë për kredi nga të dy segmentet, e veçanërisht nga ekonomitë familjare. Në tremujorin vijues, oferta kreditore pritet të lehtësohet deri në një masë për NVM-të në kuadër të ndërmarrjeve, si dhe për ekonomitë familjare në përgjithësi. Ndërsa, kërkesa për kredi pritet të shënoj rritje të lartë për të dy segmentet.

Bazuar në rezultatet e anketës, **standardet kreditore** për ndërmarrjet mbetën përgjithësisht të pandryshuara, por me lehtësim marginal vetëm për NVM-të. Kushtet dhe rregullat e ofruara u lehtësuan deri në një masë kryesisht për NVM-të, veçanërisht në kërkesat për kolateral dhe madhësinë mesatare të kredisë (Tabela 1). Komponentë me rëndësi në dinamikën e kreditimit gjatë kësaj periudhe ishte rritja e nivelit të aprovimeve nga bankat për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, e veçanërisht për NVM-të. **Kërkesa për kredi mbeti e lartë**, e nxitur kryesisht nga nevoja për financim të kapitalit punues dhe investimeve fikse. **Cilësia e kredive** u përmirësua lehtë, me rënie të nivelit të kredive joperformuese. Në TM2 2025, bankat presin rritje më të lartë të kërkesës për kredi, ndërsa lehtësim marginal të standardeve kreditore për NVM-të.

Për ekonomitë familjare, **standardet kreditore** u lehtësuan në përgjithësi, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për kreditë konsumuese. Në kuadër të kushteve dhe rregullave të ofruara, kishte lehtësim më të madh për maturitetin e kredive dhe kërkesën për kolateral për blerjen e shtëpive, si dhe rritje të madhësisë mesatare të kredisë për kreditë konsumuese. Gjithashtu, kishte rritje të nivelit të aprovimit nga bankat për të dy llojet e kredisë, në veçanti për kreditë konsumuese. **Kërkesa për kredi mbeti e lartë**, veçanërisht për kreditë për blerje të shtëpive dhe ato me maturitet afatgjatë. Rritja e kërkesës për kredi vlerësohet të jetë ndikuar pozitivisht nga perspektiva e tregut të patundshmërive, rritja e shpenzimeve të konsumit dhe rritja e besueshmërisë së konsumatorit. **Cilësia e kredive** u përmirësua, me rënie të lehtë të kredive joperformuese. Në TM2 2025, kërkesa për kredi pritet të rritet më tej, si dhe pritet lehtësim marginal i standardeve kreditore për ekonomitë familjare në përgjithësi (Tabela 1).

Qasja në financim shënoi rritje në TM1 2025, por përgjithësisht ishte në nivel më të ulët nga tremujori paraprak. Financimi nga depozitat e ekonomive familjare vazhdon të jetë i lartë, ndërsa depozitat e korporatave jo-financiare shënuan rritje por në nivel më të ulët nga tremujori i kaluar. Në tremujorin në vijim, pritet rritje e përshpejtuar e qasjes në financim.

Pritjet e bankave për inflacionin konsistojnë në rritje të lehtë në tremujorin e dytë të vitit 2025, ndërsa presin që niveli i përgjithshëm i inflacionit në 2025 të jetë dukshëm më i lartë krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore.

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM1 2025	TM2 2025 (pritjet)	TM1 2025	TM2 2025 (pritjet)
Ndërmarrjet	➡	➡	⬆	⬆
NVM	➡	➡	➡	⬆
Ndërmarrjet e mëdha	➡	➡	➡	⬆
Ekonomitë familjare	⬆	➡	⬆	⬆
Kredi për blerjen e shtëpive	➡	➡	⬆	⬆
Kredi konsumuese	➡	➡	⬆	⬆

- ⬆ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
- ➡ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
- ➡ Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
- ➡ Shtyrje në standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
- ⬆ Shtyrje në standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)


Burimi: BQK.

1.0 Kreditë ndaj ndërmarrjeve

1.1 Standardet kreditore


Bazuar në rezultatet e anketës për TM1 2025, standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet mbetën kryesisht të pandryshuara (Grafiku 1). Për NVM-të, u raportua lehtësim i standardeve kreditore nga një bankë me rëndësi sistemike me qëllim diversifikimin e portfolios kreditore, ndërsa bankat e tjera deklaruan për standarde kryesisht të pandryshuara, si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha.

Grafiku 1. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet



Faktorët kryesor që ndikuan pozitivisht në standardet kreditore gjatë tremujorit të parë të vitit ishin pozita e mirë e likuiditetit dhe mbështetja nga FKGK-ja. (Grafiku 2).

Grafiku 2. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet




Për TM2 2025, standardet kreditore në përgjithësi pritet të mbesin të pandryshuara. Sipas deklarimit të një banke me rëndësi sistemike, standardet kreditore për NVM-të pritet të lehtësohen edhe gjatë tremujorit të ardhshëm. Ndërkohë, bankat tjera deklaruan se do të vazhdojnë të aplikojnë standarde kryesisht të pandryshuara. Faktorët përcaktues të standardeve kreditore nuk pritet të kenë ndryshime të rëndësishme nga tremujori paraprak.

1.2 Kushtet dhe rregullat

Në TM1 2025, kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet ndryshuan lehtësisht në të dy kahjet, duke neutralizuar në masë të madhe efektin e këtyre faktorëve në nivel të përgjithshëm (Grafiku 3). Konkretisht, për NVM-të kishte lehtësim në madhësinë mesatare të kredisë dhe kërkesat për kolateral, sipas deklarimit të dy bankave me rëndësi sistemike, ndërsa kishte shtyrje në normën e interesit e raportuar nga një bankë me rëndësi sistemike dhe një bankë jo-sistemike. Për

ndërmarrjet e mëdha, një bankë me rëndësi sistemike raportoi për lehtësim në kërkesën për kolateral, ndërsa dy banka, njëra nga të cilat me rëndësi sistemike, njoftuan për shtrëngim në normën e interesit.

Grafik 3. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Kushtet dhe rregullat kreditore u ndikuan pozitivisht nga mbështetja e FKGGK-së, pozita e mirë e likuiditetit dhe konkurrenca ndërbankare. Në anën tjetër, qasja në gjithsej financimin e bankave vendore ka ndikuar në kahun shtrëngues të kushteve dhe rregullave kreditore, sipas raportimit nga një bankë me rëndësi sistemike.


Në tremujorin vijues, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të mbeten kryesisht të pandryshuara. Vetëm dy banka jo-sistemike kanë deklaruar që presin shtrëngim të lehtë në kërkesën për kolateral, maturitet dhe normën e interesit. Në përgjithësi, nuk priten ndryshime të rëndësishme të faktorëve që përcaktojnë kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet.

Në TM1 2025, **niveli i aprovimit të kredive** për ndërmarrjet shënoi rritje të lartë. Kreditë për NVM-të dhe ato afatgjata u karakterizuan me një nivel relativisht më të lartë aprovimi, krahasuar me kreditë për ndërmarrjet e mëdha dhe ato afatshkurtra.

1.3 Kërkesa për kredi

Sipas rezultateve të anketës për TM1 2025, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet mbeti e lartë, por në nivel më të ulët krahasuar me tremujorin paraparak. Kërkesa për kredi ka qenë më e lartë nga NVM-të, kundrejt kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e mëdha (Grafiku 4).

Grafiku 4. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Faktorët kryesor që ndikuan përgjithësisht kërkesën për kredi nga ndërmarrjet ishin nevoja për financim të inventarit dhe kapitalit punues si dhe investimeve fikse, përderisa një bankë me rëndësi

sistemike deklaroi si faktorë edhe nevojën për financimin e bashkimeve, blerjeve dhe ristrukturimit të korporatave.

Ashtu si në tremujorin paraprak, bankat raportuan për cilësi të pandryshuar të aplikacioneve të pranuar, dinamikë që pritet të mbetet e pandryshuar edhe në TM2 2025 (Grafiku 5).

Grafik 5. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Në TM2 2025, kërkesa për kredi pritet të jetë akoma më e lartë, ku tetë nga bankat e përfshira në anketë deklaruan për rritje. Rritje më të theksuar pritet për NVM-të dhe kreditë afatgjata sesa për ndërmarrjet e mëdha dhe ato afatshkurtra. Kërkesa kreditore prej ndërmarrjeve pritet të ndikohet në masë të madhe nga nevoja për financim të kapitalit punues, ndërkohë me rritje por me ndikim më të vogël pritet të jetë kërkesa për investimet fikse.

1.4 Cilësia kreditore

Bankat në përgjithësi raportuan për rënie të nivelit të kredive joperformuese (KJP). Kjo rënie u ndikua nga rezultatet e tri bankave, dy prej të cilave me rëndësi sistemike. Ndërsa, për rritje të nivelit të KJP-ve deklaroi një bankë jo-sistemike, përderisa bankat tjera raportuan stabilitet të këtij treguesi.


Për TM2 2025, pritet rritje e vogël e KJP-ve, e ndikuar nga deklarimi i një banke me rëndësi sistemike dhe një banke jo sistemike.

2.0 Kreditë ndaj ekonomive familjare

2.1 Standardet kreditore

Sipas rezultateve të anketës për TM1 2025, standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë, si për kreditë për blerje të shtëpive edhe për kreditë konsumuese (Grafiku 6). Një bankë me rëndësi sistemike raportoi për lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore për kreditë për blerje të shtëpive. Po ashtu, dy banka, njëra prej të cilave me rëndësi sistemike, njoftuan për lehtësim të standardeve kreditore të aplikuara për kreditë konsumuese.


Grafiku 6. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Faktorët që ndikuan pozitivisht në standardet kreditore përfshijnë pozitën e likuiditetit bankar, konkurrencën e rritur ndërbankare, rritjen e besueshmërisë ndaj kredimarrësve dhe uljen e normës së Euribor-it. Megjithatë, këto efekte pozitive u neutralizuan deri në një masë nga shqetësimet lidhur me cilësinë e portofolit kreditor (Grafiku 7).

Grafiku 7. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, pritet që standardet kreditore të lehtësohen deri në një masë për ekonomitë familjare. Sipas rezultateve të anketës, një bankë me rëndësi sistemike pret të ketë lehtësim të standardeve për kreditë konsumuese, ndërsa dy banka jo-sistemike presin lehtësim të standardeve për kreditë për blerje të shtëpive.

2.2 Kushtet dhe rregullat

Në TM1 2025, kushtet dhe rregullat e aplikuara në kreditë e reja për ekonomitë familjare lëvizën në të dy kahjet, me efekt dominues në kahun pozitiv (Grafiku 8). Dy banka me rëndësi sistemike raportuan për lehtësim deri në një masë në madhësinë mesatare të kredisë, maturitetet dhe kërkesën për kolateral. Në anën tjetër, norma e interesit u shtrëngua deri në një masë, veçanërisht për kreditë për blerje të shtëpive. Faktorët që ndikuan në kahun lehtësues të kushteve dhe rregullave të aplikuara ishin konkurrenca nga institucionet e tjera bankare, pozita e mirë e likuiditetit dhe perspektiva e tregut të patundshmërive.

Grafik 8. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Gjatë TM2 2025, pritjet të ketë lehtësim në madhësinë mesatare të kredisë, maturitetet dhe kërkesën për kolateral, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për ato konsumuese.

Niveli i aprovimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare ka shënuar rritje të lartë në tremujorin e parë të vitit 2025. Kreditë konsumuese dhe ato me maturitet afatgjatë u karakterizuan me nivel më të lartë të aprovimit, krahasuar me kreditë për blerje të shtëpive dhe ato me maturitet afatshkurtër.

2.3 Kërkesa për kredi

Bazuar në rezultatet e anketës për TM1 2025, kërkesa kreditore nga ekonomitë familjare ishte e lartë, si për kreditë konsumuese ashtu edhe për ato për blerje të shtëpive (Grafiku 9). Kreditë për blerje të shtëpive dhe ato me maturitet afatgjatë u karakterizuan me kërkesë më të lartë, për dallim nga tremujori paraprak, kur kërkesa ishte më e theksuar për kreditë konsumuese dhe ato me maturitet afatshkurtër.


Grafik 9. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Sipas deklarimeve të bankave në anketë, rritja e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare u ndikua pozitivisht nga perspektiva e tregut të patundshmërive, rritja e shpenzimeve të tjera për konsum dhe rritja e besueshmërisë së konsumatorit (Grafiku 10).

Grafik 10. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Bankat presin përshpejtim të rritjes së kërkesës për kredi në tremujorin e dytë të vitit 2025, si për kreditë konsumuese dhe për kreditë për blerje të shtëpive.

Në TM1 2025, dy banka me rëndësi sistemike theksuan një rritje të cilësisë së aplikacioneve të pranuara nga ekonomitë familjare, ndërsa bankat e tjera deklaruan se nuk kishte ndryshime në cilësinë e aplikacioneve të pranuara.

2.4 Cilësia kreditore


Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore për ekonomitë familjare, tri banka me rëndësi sistemike deklaruan për rënie të nivelit të kredive jo-performuese, ndërsa një bankë jo-sistemike ka deklaruar për rritje të nivelit të kredive jo-performuese. Bankat e tjera deklaruan nivel kryesisht të pandryshueshëm.

Cilësia e portfolios kreditore për ekonomitë familjare pritet të përmirësohet tutje gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025.

3.0 Financimi

Në TM1 2025, rezultatet e anketës tregojnë për rritje deri në një masë të qasjes në financim në përgjithësi, për dallim nga tremujori i kaluar ku kishte rritje të konsiderueshme. Financimi nga depozitat e ekonomive familjare vazhdon të jetë i lartë, ndërsa depozitat e korporatave jo-financiare shënuan rritje por më të ulët nga tremujori i kaluar. Sipas maturitetit, rritje më të lartë shënoi financimi afatgjatë krahasuar me rritjen e financimit afatshkurtër (Grafiku 11).

Grafik 11. Ndryshimi në financimin e e sektorit bankar



Burimi: BQK.

Në tremujorin e ardhshëm pritet përshpejtim i rritjes së qasjes në financim, si nga depozitat e ekonomive familjare dhe korporatave jo-financiare, ashtu edhe nga burimet e tjera të financimit.

3.1 Përmbledhje e pyetjeve të fokusuara.

Pyetësi i anketës për TM1 2025 është plotësuar me dy pyetje shtesë, të cilat synojnë të identifikojnë ndikimin e ofertës kreditore në rritjen e përsheptuar të kreditimit gjatë vitit të kaluar (2024) dhe vlerësimin e rrezikut kreditor nga bankat si rezultat i ngrirjes/ndërprerjes së financimit nga organizatat qeveritare amerikane.

Sipas deklarimeve të bankave, në vitin 2024 nuk ka pasur ndryshime të mëdha strukturore në ofertën kreditore dhe se rritja e kreditimit është nxitur kryesisht nga nevoja e shtuar e bizneseve dhe ekonomive familjare për financim. Megjithatë, në rritjen e përsheptuar të kreditimit deri në një masë kanë ndikuar edhe një sërë faktorësh që kanë përmirësuar kushtet e ofertës kreditore. Kampanjat për produktet kreditore dhe mbështetja nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) kanë lehtësuar qasjen në financim për klientët. Po ashtu, konkurrenca midis bankave është intensifikuar, çka ka sjellë kushte më të favorshme për klientët. Për më tepër, stabiliteti i sistemit financiar në vend ka luajtur një rol pozitiv, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për zgjerimin e mëtejshëm të kreditimit. Ndërsa, sa i përket pyetjes mbi efektin e ngrirjes/ndërprerjes së financimit nga organizatat qeveritare amerikane në rrezikun kreditor, shumica e bankave kanë raportuar se nuk kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë nga këto zhvillime. Disa banka nuk kanë pasur ekspozim për klientët e kësaj kategorie, ndërsa ato banka që kanë pasur ekspozim, kanë theksuar se nuk kanë vërejtur përkeqësim të pagesave nga klientët, dhe se shumica e këtij ekspozimi është i mbuluar me kolateral. Megjithatë, bankat që kanë ekspozime do të vazhdojnë të monitorojnë situatën për të vlerësuar ndikime të mundshme në të ardhmen.

Sa i përket përgjigjeve të disagreguara të bankave për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik, për standardet kreditore si dhe kushtet dhe rregullat e aplikuara, ato mbetën kryesisht të pandryshuara, me tendencë të lehtë shtrënguese për sektorin e ndërtimit, por në nivel më të ulët nga tremujori paraprak. Kërkesa kreditore shënoi rritje nga të gjithë sektorët, me theks të veçantë për sektorin e pasurisë së paluajtshme banesore. *Në tremujorin vijues, pritjet të ketë lehtësim të standardeve kreditore për sektorin e shërbimeve sipas deklaramit të një banke me rëndësi sistemike, kurse për sektorët e tjerë nuk pritjet të ketë ndryshime. Kërkesa kreditore pritjet të rritet, veçanërisht për sektorin e prodhimit, shërbimeve, tregtisë dhe patundshmërisë.*

4.0 Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit

Sipas anketës së realizuar në prill 2025, bankat presin rritje të letë të inflacionit në tremujorin e dytë të vitit 2025, krahasuar me tremujorin paraprak. Për tërë vitin 2025, ato presin që niveli i inflacionit të arrijë në 2.7 përqind, që tregon një rritje të dukshme krahasuar me nivelin e inflacionit prej 1.6 përqind në vitin 2024.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM1 2025	TM2 2025	2025
1	2.9%	3.4%	4.0%
2	2.0%	2.3%	2.3%
3	2.7%	2.7%	3.1%
4	2.9%	2.0%	2.0%
5	0.7%	1.3%	2.0%
6	2.3%	2.8%	3.3%
7	1.7%	2.2%	2.7%
8	1.8%	1.9%	2.3%
9	2.0%	2.5%	3.0%
10	1.7%	1.9%	2.0%
Mesatarja	2.1%	2.3%	2.7%

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.


Figura 12 paraqet shpërndarjen e probabilitetit të raportuar nga bankat, duke treguar një siguri relativisht të lartë në lidhje me nivelin e pritshëm të inflacionit. Shpërndarja e probabilitetit është e

përqendruar rreth inflacionit të pritur, çka sugjeron një konsensus të gjerë mes bankave për nivelin e ardhshëm të inflacionit.

Bankat theksojnë se pritjet për inflacionin janë të ndjeshme ndaj zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare, për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë vendore nga importet, sidomos çmimet e energjisë. Ulja e normave të interesit nga Banka Qendrore Evropiane dhe politikat tregtare të Shteteve të Bashkuara mund të kenë ndikim në rritjen e inflacionit. Çmimet e ushqimeve, energjisë dhe materialeve të tjera të importuara kanë shkaktuar rritje të konsiderueshme të çmimeve të konsumit. Po ashtu, rritja e kostove të energjisë, pasiguria ndërkombëtare dhe shpenzimet e diasporës mund të ushtrojnë presion shtesë mbi inflacionin. Për më tepër, rritja e tarifave të energjisë mund të nxisin një rritje të mëtejshme të çmimeve gjatë muajve të ardhshëm, duke përkeqësuar më tej presionet inflacioniste dhe duke ndikuar në shpenzimet e konsumatorëve.

Si përfundim, të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2025 tregojnë rritje të dukshme të inflacionit, me normë mesatare prej 2.0 përqind, krahasuar me 0.7 përqind që ishte në tremujorin paraprak. Për vitin 2025, bankat presin një nivel inflacioni prej 2.7 përqind. Këto pritje për rritje të inflacionit janë në përputhje me trendin rritës të inflacionit, i cili, vetëm në muajin mars 2025, ka shënuar rritje prej 2.8 përqind.

Grafik 12. Probabiliteti i inflacionit për TM2 2025 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulimet e BQK-së.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetëtori i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetëtori i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetëtori i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetëtori i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritjet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetëtori i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga dymbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.1 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

Pritjet për inflacionin

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore. Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e madhe për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, shërbejnë gjithashtu si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse publiku beson se banka qendrore do të ndër marrë veprimet e nevojshme për të arritur objektivin e inflacionit, atëherë pritjet e agjentëve ekonomik për shkallën e inflacionit do të jenë më të afërta me objektivin e përcaktuar.

Pritjet e inflacionit janë gjithashtu të rëndësishme për bankat që nuk posedojnë politikë monetare, pasi ato shërbejnë si input i rëndësishëm për përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe për procesin e modelimit dhe parashikimit ekonomik. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, e cila më pas ndikon në ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual, i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Një prej metodave më të përdorura është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore dhe shoqërohen me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore: fillimisht për tremujorin aktual, pastaj për tremujorin e ardhshëm dhe për vitin në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit të të dhënave për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org